POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

KAS rrëzon kërkesën e koalicionit Berisha-Meta, lihet në fuqi vendimi i KQZ! Do kenë numërues votash vetëm në gjysmat e KZAZ-ve

2

VIDEO+FOTO/ I veshur me fanellën kuqezi, aktori amerikan Danny Glover viziton Akademinë e Arteve! Shoqërohet nga artisti Kastriot Çaushi

3

VIDEO/ Plagoset me thikë 47-vjeçari në Vlorë! Kapet autori 34-vjeçar

4

FOTO/ Kush është 51-vjeçari që u vra brenda shtëpisë së tij në Shkodër

5

Belo bukuroshi dhe pse sot dua t'i kërkoj falje Luizit!

Kronikë

Vritet 51-vjeçari në Shkodër, qiraxhiu e qëllon me armë në banesë! Shkak u bë pagesa për qiranë! Viktima 1 muaj më parë u kthye nga Anglia (VIDEO + FOTO)

Një 51-vjeçar është vrarë ditën e sotme në Shkodër. Petrit Vuksani ishte kthyer nga Anglia para një muaji, por gjeti vdekjen në banesën e tij. Shkak i vrasjes dyshohet të jetë bërë qiraja e shtëpisë që Petrit Vuksani ia kishte lënë të afërmit të tij, Lekë Vuksanit.

- Vrasja në Shkodër, del EMRI, ja kush është viktima
- FOTO/ Kush është 51-vjeçari që u vra brenda shtëpisë së tij në Shkodër
- Vrasja e 51-vjeçarit në Shkodër, reagon policia: U ekzekutua brenda shtëpisë

Redaksia
2 Maj, 12:30 | **Përditesimi: 2 Maj, 13:59**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

SHKODËR- Një 51-vjeçar është vrarë ditën e sotme në Shkodër. Petrit Vuksani ishte kthyer nga Anglia para një muaji, por gjeti vdekjen në banesën e tij. Shkak i vrasjes dyshohet të jetë bërë qiraja e shtëpisë që Petrit Vuksani ia kishte lënë të afërmit të tij, Lekë Vuksanit.

Ngjarja është regjistruar rreth orës 12:15, në lagjen 'Tom Kola'. Policia nuk e ka konfirmuar zyrtarisht, por burime për Report Tv bëjnë me dije se Petrit Vuksani dhe Lekë Vuksani janë konfliktuar fillimisht brenda banesës për çështjen e qirasë. Petrit Vuksani i ka kërkuar paratë dhe ata kanë debatuar. Më pas dyshohet se Lekë Vuksani e ka qëlluar me armë zjarri automatik, Petrit Vuksanin dhe më pas është larguar në drejtim të paditur.

LEXO EDHE:
FOTOT/ Problemet e arsimimit me kandidatët e Berishës: Zef Hila e nis në Turqi, e mbaron në Shkodër

Report Tv ka siguruar foton e viktimës Vuksani, si edhe sjell pamjet nga vendi i ngjarjes. Në pamjet që Report Tv sjell vihet re se në zonën ku ka ndodhur vrasja ka edhe kamera sigurie që mund të ndihmojnë grupin hetimor për në gjurmët e autorit, Lekë Vuksani. Ndërkohë, janë ngritur pika kontrolli për të bërë të mundur kapjen e tij.

lajm ne perditesim...

Viktima Petrit Vuksani

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 13:33

EMRI/ I kishte dhënë banesën me qira, Petrit Vuksani u vra me armë zjarri nga i afërmi i tij

Dyshohet se Petrit Vuksani që mbeti i vrarë ditën e sotme në Shkodër është qëlluar me armë zjarri nga qiramarrësi që i kishte marrë me qira banesën. Lekë Vuksani dyshohet se është autori, i cili e qëlloi për vdekje 51-vjeçarin dhe më pas u largua në drejtim të paditur.

Petrit Vuksani jeton prej vitesh jashtë shtetit dhe banesën ia kishte dhënë me qira Lekë Vuksanit, të afërmit të tij. Petrit Vuksani i ka shkuar në banesë për t'i kërkuar lekët e qirasë, por dyshohet se ata kanë debatuar dhe më pas Lekë Vuksani ka qëlluar në drejtim të 51-vjeçarit.

> *"Falë reagimit në kohë të Policisë dhe veprimeve të shpejta profesionale hetimore, është bërë i mundur identifikimi i autorit të dyshuar të vrasjes së shtetasit P. V. Shërbimet e Policisë janë vënë në ndjekje të autorit të dyshuar, shtetasit L. V., i cili dyshohet se ka vrarë me armë zjarri automatik shtetasin P. V. Vijon ndjekja dhe krehja e zonës, me qëllim kapjen e shtetasit L. V", njofton policia.*

Share

Ora 13:16

Vrasja në Shkodër, Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes! Zona me kamera sigurie

Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes në Shkodër, ku 51-vjeçari Petrit Vuksani u vra brenda banesës së tij. Në pamjet që Report Tv sjell vihet re se në zonën ku ka ndodhur vrasja, në lagjen 'Tom Kola', ka edhe kamera sigurie që mund të ndihmojnë grupin hetimor për të identifikuar autorin, apo për të rënë në gjurmët e tij.

Vuksani u vra brenda banesës së tij, ndërsa ishte i vetëm. Një person është futur dhe e ka qëlluar me armë e më pas është larguar. Ai kishte 1 muaj që ishte kthyer nga banesa.

[Shqiptarja.com]

Share

Ora 12:54

FOTO/ Kush është 51-vjeçari që u vra brenda shtëpisë së tij në Shkodër

Report Tv ka siguruar foton e 51-vjeçarit Petrit Vukasni i cili u ekzekutua mesditën e sotëm në Shkodër brenda banesës së tij. 51-vjeçari është qëlluar me armë zjarri nga persona ende të paidentifikuar ndërsa shkaqet e vrasjes janë ende të paqarta. Petrit Vuksani kishte vetëm pak ditë që ishte kthyer nga Anglia.

Share

Ora 12:53

Vrasja e 51-vjeçarit në Shkodër, reagon policia: U ekzekutua brenda shtëpisë

Policia e Shkodrës ka reaguar në lidhje me vrasjen e 51-vjeçarit Petrit Vuksani. Sipas policisë rreth orës 12:15, në lagjen "Tom Kola", në rrethana ende të paqarta, në banesë, është vrarë me armë zjarri Petrit Vukasni.

> *'Shërbimet e Policisë dhe grupi hetimor kanë shkuar menjëherë në vendngjarje. Janë ngritur pika kontrolli dhe po ushtrohet kontroll në zonë për kapjen e autorit të dyshuar.*
>
> *Grupi hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, po vijon punën për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, si dhe për sigurimin e çdo prove, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit.'- njofton policia.*

Share

Ora 12:48

DETAJET/ 51-vjeçari që u vra sot në Shkodër u kthye para një muaji nga Anglia! U qëllua me armë brenda banesës

51-vjeçari Petrit Vuksani që u vra ditën e sotme në Shkodër ishte kthyer para një muaji nga Anglia. Report Tv mëson se ai është qëlluar me armë në banesë. Mësohet se autori i ka hyrë 51-vjeçarit Petrit Vuksani në shtëpinë e tij dhe e ka ekzekutuar.

Share

Ora 12:40

Vrasja në Shkodër, del EMRI, ja kush është viktima

Një vrasje ka ndodhur ditën e sotme në Shkodër. Report Tv mëson se ka mbetur i vrarë Petrit Vuksani.

Share

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Petrit Vuksani | Shkoder | vrasja e petrit vuksanit | vrasje

Komento

Komente

Beni: 02/05/2023 13:35

Vrassesi qeka qeraxhiu i tij . Viktima mesa duket i ka kerku qeran dhe ky ne vend te qeras i dha plumbin . Ke frik te shkosh ne Shkoder se armet jan jasht kontrollit

Përgjigju

Tefa: 02/05/2023 13:25

Po si iu fut ne shtepi? Atehere vrasesi ishte nje i njohiur i tij. Kriminalitet i lart n Shkoder se esht nje qytet qe drejtohet ne form rumpalle.

Përgjigju

Viluni: 02/05/2023 13:22

Mos eshte ky qe kishte lene shpine me qera Dhe ja kishin kthyer ne depo ashashi ne velipoje ?! Se i kishte denoncu me duket qe ja kane kthy shpine Ne magazine.. dhe jane ne burg ato sot.

Përgjigju

Alex: 02/05/2023 12:54

Amita me pipke e dinte ai .... gjak pa lare edhe hak pa mare nuk ka ne kete bote. Me njeren menyre ose me tjetren do ti shlyesh ......

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
E keni vendosur se për kë do të votoni më 14 maj?

Po | Jo | Nuk votoj

Lajme të tjera

Spahia i përgjigjet Ramës: Bashkia Shkodër nuk krijon pengesa për projektet! Nuk keni lekë të mbaroni punët e nisur, mashtroni me skema 3D

2 Maj, 13:12

Alibeaj nga Vau i Dejës: Berisha-Meta-Rama fosile politike që kanë marrë peng fatet e shqiptarëve

2 Maj, 11:27

Banorët e Thethit ngrihen në protestë: Na mungon energjia elektrike, problematikë prej vitesh! U bashkohen edhe turistët

Ergys Kavaja

2 Maj, 09:54

Ylli Pata: Të panjohurat e garës së Shkodrës

Ylli Pata

1 Maj, 19:01

Velipoja çel sezonin turistik me volejboll e sporte ujore

Ergys Kavaja

1 Maj, 15:26

Tentoi të ndihmonte një vajze që të që të kalonte kufirin në Hanin e Hotit, vihet në pranga 36-vjeçari francez

1 Maj, 11:32

Mero Baze: Shkodra, një fitore që 'mërzit' shumë bashkiakët socialistë jashtë Shkodrës

Mero Baze

30 Prill, 19:27



Zaloshnja: Historiku elektoral dhe faktori 'Luiz' në Shkodër

Eduard Zaloshnja

30 Prill, 18:44

Pensionisti në Fushë-Arrëz i dorëzon teserën e partisë së PS , Berisha 'e lëvdon': Akt atdhetarie

30 Prill, 18:37

Rama takim në Shkodër: Kemi projekte shumë të mira po s’na jep leje Bashkia! Benetin e gjeta nga Berisha, por ata s’dinë ta vlerësojnë

30 Prill, 17:29

Rama publikon pamjet nga bypass i Shkodrës: Bashkia na ka zvarritur për një copë letër njësoj siç po bën me ujësjellësat e Shirokës e Zogajt

30 Prill, 15:51

Rama takim me biznesmenët në Malësinë e Madhe: Investimet këtu, sjellin të ardhura që nuk sigurohen dot kurrë në emigracion

30 Prill, 14:50

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje